

INTERVISTË ME MENTOR QOKUN, NËNKRYETAR I KE TË LSHPM

BASHKËPUNIM ME FAKTE DHE ARGUMENTE

Mendoj se duke u përfshirë në shoqatën e pensionistëve unë jap kontributin tim për avancimin e organizimit pensionist, në përmbushjen e qëllimeve për të cilat janë të formuara shoqatat e pensionistëve

Për momentin, gjegjësisht në këtë mandat 2019-2023, ju kryeni një nga funksionet më të larta në udhëheqjen e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Çfarë ju motivoi të pranoni këtë pozicion me përgjegjësi shoqërore?

QOKU: Unë jam jurist i diplomuar me profesion dhe para se të dilja në pension kam kryer disa funksione shoqërore të përgjegjshme. Pas pensionimit, vendosa të jem aktiv edhe si pensionist për disa arsye. Ndjeva se përvoja dhe njohuritë e mia mund të ishin në dobi të pensionistëve të shoqatës time amë. Unë gjithmonë kam dashur të jem i dobishëm në çdo mënyrë, jam rritur në një familje ku ushqehet respekti për më të moshuarit dhe ndjeva se kisha forcën dhe energjinë që mund të përdorej për t'i dhënë përmbajtje ditëve të mia të pensionit, ose siç themi, të plakem në mënyrë aktive. Mendoj se duke u përfshirë në shoqatën e pensionistëve unë jap kontributin tim për avancimin e organizimit pensionist, në përmbushjen e qëllimeve për të cilat janë të formuara shoqatat e pensionistëve. Më vonë, pasi u njoh ekspertiza ime, u zgjedha në Forumin juridik-ekonomik, një organ i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, e cila përbëhet ekskluzivisht nga pensionistë të specializuar në çështje ekonomike dhe juridike, pastaj isha anëtar i Kuvendit dhe Bordit Ekzekutiv, dhe sot jam Nënkyetar i KE të LSHPM, që për mua është një nder por edhe një përgjegjësi e madhe, sepse siç



dihet, në këtë shoqatë qytetare janë anëtarë mbi 280 000 pensionistë, të organizuar në 53 shoqata komunale që kanë një sërë problemesh që duhen zgjidhur.

Me çka kryesisht jeni të angazhuar si nënkryetar i KE të LSHPM?

QOKU: Vetë emri i funksionit i tregon përgjegjësitë dhe detyrat e mia. Ato janë definuar edhe në Statutin tonë, e zëvendësoj kryetarin në rast të mungesës së tij, kujdesem për realizimin e planit financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve të Lidhjes dhe për përgatitjen në kohë të llogarisë përfundimtare të të ardhurave dhe shpenzimeve të Lidhjes; së bashku me kryetarin përgatis materiale për seancat e Kuvendit dhe Bordit Ekzekutiv, kryej edhe detyra të tjera të dhëna nga kryetari dhe Bordi Ekzekutiv, të cilat përcaktohen në rregullore dhe në aktet dhe vendimet tjera.

Cili është bashkëpunimi juaj me anëtarët e tjerë të udhëheqësive të LSHPM, por edhe me udhëheqësinë e 53 shoqatave të pensionistëve, anëtare të Lidhjes?

QOKU: Edhe tani si nënkryetar i KE të LSHPM, dhe më parë, bashkëpunimi im me anëtarët e tjerë të udhëheqësive të LSHPM, por edhe me udhëheqësitë e 53 shoqatave të pensionistëve, anëtarë të Lidhjes, ishte konstruktiv dhe i sinqertë. Unë gjithmonë përpiqem të mbështes bashkëpunimin në fakte dhe argumente, në të vërtetën, duke përdorur njohuritë dhe përvojën time. Sjellja ime do të jetë në atë drejtim edhe në të ardhmen.

Nën autoritetin tuaj është puna e Bordit të Organizatës së regjistruar për anëtarësim dhe Fondit të solidaritetit. Na tregoni nëse jeni të kënaqur me gjendjen dhe funksionimin e tij?

QOKU: Po, unë jam kryetari i këtij bordi. Që nga fillimi i mandatit, së bashku me kryetaren e LSHPM, ne i vendosëm vetes detyrën për të azhurnuar të dhënat e anëtarëve të të gjitha shoqatave të pensionistëve, anëtarëve të lidhjes tonë, si dhe në tre lidhjet e pensionistëve me aftësi të kufizuara, që do të thotë mbi 310 000 anëtarë në të gjitha lidhjet. Kjo punë është mjaft e komplikuar, veçanërisht duke marrë parasysh që për një kohë të gjatë nuk

ishte bërë identifikimi i anëtarëve nga lidhjet dhe shoqatat. Për të përfunduar këtë punë, na është dashur të mbajmë disa takime me përfaqësuesit e Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Është punuar shumë dhe kemi bërë shumë përpjekje. Ne jemi kërenarë për rezultatet e arritura sepse kemi krijuar kushte që anëtarësimi në shoqata të paraqitet sipas numrit aktual të vetë shoqatës. Koha e pandemisë, krahas projekteve të tjera në LSHPM, mundësoi që kjo punë të përfundojë me sukses.

Ju jeni një nga drejtuesit e paktë në pension që kurrë nuk keni ndarë pensionistët mbi baza etnike, prandaj jeni kaq të respektuar. Cila është arsyeja për këtë: karakteri, edukimi apo arsime juaj?

QOKU: Mund të thuhet se edukata, arsime dhe karakteri, por ka sigurisht edhe elementë të tjera që ndikuan që unë të respektohem. Jam i bindur që nëse respektoni dikë, prisni që edhe ai të ju respektojë. Unë jam rritur nga familja ime për të respektuar njerëzit pavarësisht nga ndryshimi kombëtar, fetar ose ndonjë tjetër. Unë jam edukuar në atë frymë dhe arsime im sigurisht që kontribuon për këtë. E gjithë kjo më bën të lumtur dhe të kënaqur.

Lidhja aktualisht po funksionon në kushte specifike për shkak të pandemisë së koronavirusit. A vazhdon Lidhja t`i realizojë aktivitetet e zhvendosura në Programin për vitin 2021, veçanërisht kur bëhet fjalë për aktivitetet tradicionale?

QOKU: Sigurisht. Jeta duhet të vazhdojë. Gjithmonë ka patur dhe do të ketë sfida dhe probleme. Ne të rriturit duhet të dimë si të ballafaqohemi për shkak vetes tonë, por

edhe si shembull për gjeneratat e reja. Shpresoj që do t`i mbajmë shfaqjet folklorike të këngëve, muzikës dhe lojërave dhe garat e 25-ta jubilarë sportive, natyrisht në përmbajtjet dukshëm të ndryshuar të përshtatur ndaj kushteve për shkak të pandemisë së korona virusit. Normalisht, nëse institucionet kompetente nuk sjellin ndonjë ndalesë, që do të thotë se gjithçka varet nga zhvillimi i kësaj pandemie të rëndë. Ata nuk do të dëshojnë të jenë në fokusin e veprimit dhe aktiviteteve tona humanitare, sepse 2021 është shpallur viti i aktiviteteve humanitare nga ana e Lidhjes. 75 vjetori i organizatës së pensionit në Maqedoni do të festohet me modesti dhe dinjitet.

Cilat janë planet tuaja, si shoqërore ashtu edhe personale?

QOKU: Unë do të bëj çmos, natyrisht brenda kufijve të mundësive të mia, për të kryer të gjitha detyrat e caktuara me përgjegjësi, transparencë dhe ligjërisht, pasi në fakt e gjithë udhëheqja e Lidhjes punon, si një ekip, me respekt të ndërsjellë dhe bashkëpunim konstruktiv. Pa atë, nuk do të ketë rezultate, as në LSHPM, as në shoqata dhe tërë energjia të drejtohet në interes të anëtarëve. Në nivelin personal, do të përpiqem të kujdesem për shëndetin tim dhe të dashurve të mi, si dhe të tjerëve përreth meje.

Çfarë do të rekomandoni për pensionistët si kolegë dhe miq të tuaj?

QOKU: Të jemi pozitiv dhe të mos i humbim ditët tona në gjëra të parëndësishme. Të jemi të bashkuar, të mbështesim njëri-tjetrin, ta respektojmë dhe ndihmojmë njëri-tjetrin.

(Bisedën e realizoi: Kalina S. Andonova)

SHP STRUGË

NJËZET VITE PENSIONIST AKTIVIST

Zijai është ndër të paktët pensionistë, i cili megjithëse jeton në fshat, vjen çdo ditë në Klubin e Pensionistëve të SHP Strugë, i vendosur në mjediset e shoqatës së pensionistëve dhe përfshihet në të gjitha aktivitetet

Zija Arslani, i lindur më 1936 në Livadhi të Strugës, është një nga pensionistët më të vjetër të Strugës, i cili kohët e fundit e festoi ditëlindjen e tij të 85-të. Arsyeja për të shkruar një tekst për Zija Arslanin, është fakti që ai ka qenë një pensionist aktivist për njëzet vjet. Pikërisht 20 vjet para pensionimit të tij, ai filloi dhe formoi një degë pensionistësh në fshatin Livadhi, e cila përfshin fshatrat Dellogozhdë, Koroshishtë, Poum dhe Misllodezhdë. Zija Arslani, i cili është kryetar i degës, për dy man-

date u zgjedh personi i dytë i SHP Strugë dhe kryen funksionin vullnetar të nënkryetarit të Bordit Ekzekutiv në Shoqatën e Strugës.

Kush është Zija Arslani? Dëshira për një jetë më të mirë e bëri atë të punonte shumë i ri në Fabrikën e duhanit në Ohër, Njësia rajonale Strugë. Punësimi në qytet i mundësoi atij një jetë më të mirë. Për angazhimin e tij jo egoist në punën e tij, ka qenë i shpërblyer me shumë mirënjohje dhe falënderime, ndërsa në atë kohë ai ishte i vetmi kryetar i Shoqatës së fa-

brikës së duhanit në Ohër - njësi rajonale Strugë.

Si një njeri i ndershëm dhe i sinqertë, ai e përqendroi jetën e tij në njerëzimin, në ndihmën ndaj njerëzve, dhe pas daljes në pension, edhe të pensionistëve. Modesti, i qetë, por i sigurt në gjithçka. Kështu e njohin tani, i cili i ka ndërjerë përfitimet e pensionimit tashmë 20 vjet. Zijai është ndër të paktët pensionistë, i cili megjithëse jeton në fshat, vjen çdo ditë në Klubin e Pensionistëve të SHP Strugë, i vendosur në mjediset e

shoqatës së pensionistëve dhe përfshihet në të gjitha aktivitetet.

Ditët e pensionit, ky pensionist i butë, vital dhe me shëndet të mirë, kur është në fshat, shikon televizion ose i pret dhe përcjell të afërmit nga familja e tij që vijnë për ta vizituar. Mëngjesin e fillon me kafe dhe një gotë raki. "Unë i ndihmoj njerëzit çdo ditë, veçanërisht të moshuarit. Ata janë njerëz të moshuar dhe më thërrasin për t'i ndihmuar ose për të kryer ndonjë punë. Unë ndihmoj aq sa mundem. Angazhimi më bën të



lumtur, të përmbushur dhe shpirtërisht më të pasur. Kam arritur shumë në jetë, por prapë për mua pasuria më e madhe ishte dhe mbetet familja ime", thotë bashkëbiseduesi ynë i mençur, Zija Arslani. S. Kukuneshoski